



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Plani i Punës për vitin 2021

Komiteti për Komunitete, në vitin 2021, angazhimin punët dhe aktivitetet do t'i fokusojnë përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësisë mbi bazën e dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe detyrave të përcaktuara me këtë Plan, në veçanti:

- Implementimi i Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas.

Detyrë e përhershme

- Mbikëqyrja në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e plotë të të drejtave, lirive dhe interesave të bashkësive etnike që jetojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Detyrë e përhershme

- Angazhim në ruajtjen dhe mbrojtjen e identiteteve dhe vlerave etnike , kulturore, fetare , mendimit politik dhe çfarëdo mendimi tjetër pavarësisht nga përkatësia etnike.

Detyrë e përhershme

- Avancimi i marrëdhënieve të mira ndëretnike

Detyrë e përhershme

- Rekomandime të masave, organeve përkatëse, për çështje për të cilat gjatë punës dhe aktiviteteve vlerëson se janë të nevojshme në realizimin e plotë të të drejtave të garantuara ligjore si dhe dispozitave të Konventave përkatëse ndërkombëtare.

Detyrë e përhershme

- Përcjellja vazhdueshme e institucioneve të Komunës në aspektin e respektimit të dispozitave ligjore , politikat dhe praktikat e Komunës si dhe aktivitetet në realizmin e plotë të të drejtave të bashkësive etnike

Detyrë e përhershme

- Kujdesi i vazhdueshëm që në Komunë gjuhët zyrtare të jenë në përdorim të barabartë për pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike, të kenë status të njëjtë në punët dhe aktivitetet e organit përfaqësues dhe organit të Ekzekutivit të Komunës si dhe që çdo qytetarë të ketë të drejtën e shprehjes së lirshme pran institucioneve të Komunës në gjuhët dhe alfabetet zyrtare.

Detyrë e përhershme

- Kujdesi për respektimin e mënyrave , procedurave dhe kushteve për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes, planifikimeve dhe përgjegjësi të në kuadër të kompetencave të Komunës

Detyrë e përhershme

- Kujdesi për përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi të Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit dhe Ekzekutivit të Komunës për punë transparente dhe krijimin e mundësive dhe mekanizmave për informim të mirëfilltë të pjesëtarëve dhe subjekteve të të gjitha komuniteteve, për punët dhe aktivitetet e përditshme të Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit dhe Ekzekutivit në përgjithësi

Detyrë e përhershme

- Shqyrtimi i të gjitha propozim Rregulloreve dhe akteve tjera të përgjithshme të cilat procedohen për miratim në Kuvendin e Komunës

Detyrë e përhershme

- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe ankesave të cilat i drejtohen këtij Komiteti.

Detyrë e përhershme

- Shqyrtimi i propozimit të Planit të punës për vitin 2021.

Maj2021

- Vizitë e komuniteteve pakicë në rrugën “Xhafer Meta” në Podujevë

Qershor2021

- Vizitë e komuniteteve pakicë në rrugën “Ali Ajeti” në Podujevë.

Qershor 2021

- Vizitë e komuniteteve pakicë dhe shkollës fillore në fshatin Batllavë dhe Orllan.

Qershor2021

- Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2020/2021 me theks në suksesin dhe vijueshmërinë e nxënësve të komuniteteve ashkalinj dhe rom.

Korrik 2021

- Identifikimi i nxënësve të komuniteteve pakicë të cilët eventualisht e kanë ndërprerë shkollimin dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor

- Identifikimi i personave të komuniteteve pakicë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin e mesëm dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor joformal për përfundimin e klasave përkatëse

Korrik2021 (java e parë)

- Informatë për fillimin e vitit shkollor 2019/2020, gjendja aktuale e nxënësve të komuniteteve ashkalinj dhe rom dhe egjiptas, sfidat dhe vështirësitë

Shtator 2021

- Vizitë e komuniteteve pakicë dhe shkollës fillore në fshatin Orllan

Shtator 2021

- Vizitë në shkollat fillore të Mesme të Ulëta: “Naim Frashëri” dhe “Shaban Shala” në Podujevë

Tetor2021

- Shqyrtimi i mundësive për gjetjen e donatorëve eventual për sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje gjatë dimrit për familje me nevojë të komuniteteve pakicë.

Tetor 2021

- Analizë e realizimit të Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021, çdo tre muaj.

Shqyrtimi i Informatave të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, sipas nevojës

Shqyrtimi i realizimit të rekomandimeve të këtij Komitete, drejtuar strukturave relevante të nivelit lokal dhe nivelit qendror, çdo tre muaj.

Në funksion të shkëmbimit të përvojave me Komitetet e Komuniteteve, vizita në komunat e Republikës së Kosovës:

- Komuna e Ferizajt,
- Komuna e Fushë Kosovës

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, në bashkëpunim dhe koordinim me anëtarët e Komitetit i cakton datat e vizitave sipas këtij plani.

Bashkëpunimi Komiteti për Komunitete, gjatë vitit 2021, në vazhdimësi do të bashkëpunoj dhe aktivitetet do t'i bashkërendoj, me :-Institucionet relevante të Komunës, në veçanti me Zyrën për Komunitete dhe Kthim-Ministrinë për Komunitete dhe Kthim-Kabinetin e Kryeministrit -Zyrën për Komunitete-OSBE-në, -KFOR-in, -Njësitin për komunitete të Stacionit të policisë në Podujevë, -Policinë rajonale kufitare Veriu në Lluzhan, -Ekipet vepruese për siguri në bashkësi të Komunës së Podujevës,-OJQ-të e ndryshme, për mbështetje në implementimin e Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas-Subjektet tjera relevante

Mbledhjet Komiteti për Komunitete do të mbajë mbledhje sipas nevojës dhe së paku një mbledhje gjatë çdo muaji

Nr.prot.01-060/01-0033357/21
Podujevë,
19 prill 2021

Kryesuesja e Komitetit
Albina Avdiu